

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut, për t’i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2017 në drejtim të:

- Identifikimit, parandalimit dhe orientimit të problematikave në tregje të ndryshme sensitive të ekonomisë, me synim nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, që i shërben mbi gjithçka interesave të konsumatorit.

- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative nëpërmjet rristurimit të institucionit për t’iu përshtatur më mirë diversitetit të tregjeve dhe nevojave të vetë zhvillimit ekonomik të vendit.

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, duke synuar përafrimin me standardet ndërkombëtare, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin edhe nga procesi i integritetit në BE.

- Realizimit të një veprimtarie aktive në drejtim të mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në proceset gjyqësore.

- Realizimin e advokacisë së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit proaktiv me anë të aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin e biznesit.

Kuvendi rekomandon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2018, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të forcojë bashkëpunimin me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve, dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në të mirë të të gjithë konsumatorëve shqiptarë.

- Të mbikëqyrë tregun e telefonisë celulare pas transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit “Plus Communication” sh.a. te sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. dhe “Telekom Albania” sh.a. Të realizojë vlerësimin e tregut pas përqendrimit, mbështetur në analizën e AKEP-it, për t’u siguruar që sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e telefonisë celulare nuk sjell efekte antikonkurrese, si dhe të monitorojë ndikimin e transaksionit në tregun e shitjes me pakicë dhe në konsumatorin fundor.

- Të monitorojë në vazhdimësi sjelljen e ndërmarrjeve që u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, për të evidentuar dhe shmangur situata monopolistike, si edhe të monitorojë zbatimin e rekomandimeve, dhënë organeve shtetërore nga Komisioni i Konkurrencës, sipas tregjeve që ato rregullojnë.

- Të përpiqet për materializimin me objektivitet të gjithë vendimmarrjes dhe gjetjen e rrugëve për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të marra në vite nga Komisioni i Konkurrencës.

- Të mbikëqyrë në vazhdimësi ato tregje ku ushtrojnë veprimtari ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu në rritje, për të garantuar zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

- Të përmirësojë nivelin e ekspertizës së stafit për t’iu përshtatur dinamikës së tregjeve në zhvillim e gjithmonë e më komplekse.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe të miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

- Duke zbatuar rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg.

Miratuar në datën 3.5.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi